



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.52

2004

30 korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.477, datë 16.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinzë	3447
Vendim i KM nr.478, datë 16.7.2004	Për pranimet në universitetet dhe shkollat e larta, në sistemin me shkëputje nga puna, si dhe për tarifën e shkollimit për vitin akademik 2004-2005.....	3447
Vendim i KM nr.479, datë 16.7.2004	Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar	3451
Vendim i KM nr.480, datë 16.7.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Bajram Currit të mjediseve të ish-shtabit të brigadës së këmbësorisë nr.2230 në Bajram Curri, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	3452
Vendim i KM nr.481, datë 16.7.2004	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Pukës të mjediseve të ish-hotelit të ushtarakëve dhe të ish-degës së mobilizimit në Pukë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	3452

Vendim i KM nr.482, datë 16.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve	3453
Vendim i KM nr.483, datë 16.7.2004	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale.....	3459
Vendim i KM nr.485, datë 16.7.2004	Për transferimin e fondeve buxhetore bashkisë së Elbasanit, për mbulimin e shpenzimeve administrative të qendrës sociale “Balashe”.....	3463
Vendim i KM nr.487, datë 16.7.2004	Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve të bazës ndihmuese në Sarandë dhe bazës ndihmuese në Shëngjin nga Ministria e Mbrojtjes, Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe për disa ndryshime në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	3464

VENDIM
Nr.477, datë 16.7.2004

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË VENDBURIMIN PATOS-MARINZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Patos-Marinzë, ndërmjet “Albpetrol” sh.a.-së dhe shoqërisë “Saxon International Energy”, Ltd., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.478, datë 16.7.2004

**PËR PRANIMET NË UNIVERSITETET DHE SHKOLLAT E LARTA, NË SISTEMIN ME
SHKËPUTJE NGA PUNA, SI DHE PËR TARIFËN E SHKOLLIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2004-2005**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e përgjithshme e pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta, në sistemin me shkëputje nga puna për vitin akademik 2004-2005, të jetë 13 566 dhe të ndahet si më poshtë vijon:

a) Kuota e pranimeve të reja	13 086;
b) Kuota për degë të dytë	250;
c) Kuota për vite të ndërmjetme	200;
ç) Kuota për shtetasit e huaj	30.

2. Kuota e pranimeve të reja përbëhet nga:

a) Kuota kryesore	12 694;
b) Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve shtetërorë	392.

3. Kuota e pranimeve të reja për vitin akademik 2004-2005, të ndahet sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve shtetërorë të vendit: Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, konkurrojnë ndërmjet tyre për kuotat e pranimi, të përcaktuara sipas degëve, të paraqitura në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Këto kuota përfshihen në numrin e kuotave të pranimeve të reja.

5. Kuotat e pranimeve për shtetasit e huaj administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të kërkesave të paraqitura pranë universiteteve dhe shkollave të larta.

6. Kuotat e pranimeve për vitet e ndërmjetme dhe degët e dyta administrohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe shpërndahen sipas kërkesave të paraqitura nga universitetet dhe shkollat e larta.

7. Kandidatët, që do të vazhdojnë studimet në një degë të dytë, pranohen pa konkurs dhe u nënshtrohen tarifave të shkollimit. Masa e tarifës së shkollimit për degë të dytë është e barabartë me tarifën e shkollimit për kuotat dytësore. Në rastet kur ka më shumë kandidatë se kuotat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të cilësisë së rezultateve të fituara në degën e parë.

8. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, në vitin akademik 2004-2005, të jenë si më poshtë vijon:

a) Kursi i parë	10 000 (dhjetë mijë) lekë
b) Kursi i dytë	7 000 (shtatë mijë) lekë
c) Kursi i tretë, i katërt e i pestë	2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë

9. Mënyra e plotësimit të kuotave të parealizuara të pikës 1 të këtij vendimi përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bashkëpunim me shkollat e larta dhe universitetet.

10. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KUOTA TOTALE E PRANIMEVE TE REJA
PER VITIN AKADEMIK 2004-2005**

Tabela Nr. 1

Nr.	DEGA	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	AEFS	SHLI	Σ
1	Histori	130											130
2	Gjeografi	100											100
3	Histori-Gjeografi				66	57		110					233
4	Gjuhe letersi	130			120	57		175					482
5	Hist-Gjeog. Edukate Qytetare				66								66
6	Anglisht	170			75	75	75	100	105				600
7	Frengjisht	100			90								190
8	Italisht	120			75	50		100	100				445
9	Gjuhe sllave ballkan	30											30
10	Gjermanisht	100			75			75					250
11	Gjuhe letersi greke	50				50							100
12	Gjuhe Turke	30											30
13	Cikli i ulet				200	100	100	200	200				800
14	Cikli i ulet parashkollor				100	100	100	100	100				500
15	Fizikulture										120		120
16	Matematike	120					60	120					300
17	Fizike	120						110					230
18	Matematike-Fizike				120	105			70				295
19	Biologji-Kimi	70			120	100		120					410
20	Kimi e pergjithshme	50											50
21	Kimi ushqimore	50											50
22	Kimi industriale	50											50
23	Informatike	100				75		43	32				250
24	Gazetari	100			75								175
25	Pune sociale	120			75								195
26	Filozofi-sociologji	120					100						220
27	Psikologji	100						100					200
28	Shkencat politike	80											80
29	Drejtesi	300						115	75				490
30	Art skenik									60			60
31	Arte figurative									57			57
32	Muzike									100			100
33	Mjekesi	200											200
34	Stomatologji	60											60
35	Farmaci	60											60
36	Infermieri				100	100	104	100	190			333	927
37	Administrim-Biznes	350			100	57	56	63	160				786
38	Ekonomist	70			70								140
39	Finance	350			100	100	100	100					750
40	Marketing	50					56	90					196
41	Turizem						56		150				206
42	Inxh. Detare								40				40
43	Navigacion								40				40
44	Mekanike		120										120
45	Metalurgji		40										40
46	Tekstil		65										65
47	Elektrik		130										130
48	Elektronik		125										125
49	Ndertim		150										150
50	Arkitekture		100										100
51	Hidroteknike		50										50
52	Topogjeodezi		35										35
53	Inxhinieri ambienti		50										50
54	Gjeol. Min. Ngurte		60										60
55	Gjeofizike		35										35
56	Inxhinieri naftë		70										70
57	Miniera		70										70
58	Drejt. Fermash dhe AGB			170			50						220
59	Ekonomi dhe P. Agrare			170									170
60	Inxh. Agrar dhe MB			90			50						140
61	Inxh. Agrar nw Zooteknik dhe Bblek			50									50
62	Inxh. Agrar. Akuakul. M. Peshkim			52									52
63	Inxh. Mjedisë			80									80
64	Teknolog Ushqimor			82									82
65	Tek. I Lartë në Konservimin PB			50									50
66	Teknik I Lartë në Vreshtari dhe En.			50									50
67	Inxh. Pyjesh			70									70
68	Inxh. Perpunim Druri			70									70
69	Mjek Veterinar			100									100
70	Inxhinieri agronomike			80			79						159
	TOTALI	3480	1100	1114	1627	1026	986	1821	1262	217	120	333	13086

		KOSOVA								MAQEDONI					MALI I ZI				*								
Nr.	DEGA	UT	AA	UBT	SHL	UGJ	UE	AEB	UPT	UT	UPT	UBT	UE	AA	UK	UT	UPT	USH	AA	UT	UPT	UBT	AA	USH	UV	SHL	Σ
1	Histori	2								2											1						5
2	Gjeografi	1																			1						2
3	Histori-Gjeografi					2	3						3						2					1			11
4	Gjuhe letersi					2	5						5					3		1				2			18
5	His-Gje. Edukat Qytetare						3						3														6
6	Anglisht	1				2	1		1			1	1					2		1				1			11
7	Frëngjisht						1					1								1							3
8	Italisht					2	1					1						2						1			7
9	Gjermanisht						1						1						2					1			5
10	Gjuhe letersi greke					2																					2
12	Cikli i ulet					2	2						3	2				4						1			14
13	Cikli i ulet parashkollor					2	2						3	2					2					1			12
14	Fizikulture							8																			8
15	Matematike	2							1						2	1		2		1				1			10
16	Fizike	4							2							2		2		2				1			13
17	Matemat-Fizike					2	2						3												4		11
18	Biologji-Kimi	2				2	2		5			3				1		2		1				1			19
19	Kimi e përgjithme	1							1							1				1							4
20	Kimi ushqimore	1														1											2
21	Kimi industriale	1																									1
22	Informatike																	2						1	2		5
23	Gazetari																			1							1
24	Punë sociale	2							1							1				1							5
25	Filozofi-sociologji	1							3					1	1					1							7
26	Psikologji	1							3							1		2		1				1			9
27	Shkencat politike	1							1							1											3
28	Drejtesi								2							2		3		2				2			11
29	Art skenik		2										2						1					1			6
30	Arte figurative	1												1					1				1				4
31	Muzike		2										2						2								6
32	Mjekësi	2							2							1				1							6
33	Stomatologji	1							2							1				1							5
34	Farmaci	1							1							1				1							4
35	Infermieri				13	2	1							2	4				2					1	10	7	42
36	Vrështari-Enologji																										0
37	Administrim-Biznes					2			1						1			2						1			7
38	Financë					2										2			2					1			7
39	Marketing															1		2						1			4
40	Turizëm														1												1
41	Drejt. i Ferm.&AGB			2								2				2							1				7
42	Ekonomi&Politike Agr			2								2											1				5
43	Mekanikë							2	1																		3
44	Metalurgji								1	1																	2
45	Tekstil								1	1																	2
46	Elektrik							2	1									1				1					5
47	Elektronik							3	1										1								5
48	Ndërtim							2	2									1				1					6
49	Arkitektura							2	2									1									5
50	Hidroteknika							1	1																		2
51	Topogjeodezi							1	2													2					5
52	Inxhin ambientit							2																			2
53	Gjeo.Min.Ngurte								1	1																	2
54	Gjeofizikë								1	1																	2
55	Inxhinieri naftë							1	1																		2
56	Miniera							1	1																		2
57	Hort. M. Bimësh			1								1											1				3
58	Inxh. Agrar. P. Bimor			1								1			2								1				5
59	Zootekni			1								1											1				3
60	Akuakult. M. Peshkimi			1								1															2
61	Inxh. Mjedisit			1								1												1			3
62	Tek. Ushqimor			3								1												1			5
63	Inxh. Drurit			4								1												1			6
64	Inxh. Pyjesh			1								1												1			3
65	Veterinari			3									3										2				8
0	TOTALI	24	5	20	13	24	24	8	21	28	16	15	29	5	21	15	4	38	4	19	4	11	2	19	16	7	392
68																											

* - Presheve, Bujanovc, Medvegje

MASH / DAL /qershor, 2004

VENDIM
Nr.479, datë 16.7.2004

PËR RITJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS
ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi e veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar”, të rritet 2.4 për qind , duke arritur vlerat si më poshtë vijon:

a) Shpërblimi sipas shkronjës “a” të pikës 7, nga 3092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj bëhet 3166,2 (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë, e dy të qindat) lekë;

b) Shpërblimi sipas shkronjës “b” të pikës 7, nga 2476 (dy mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj bëhet 2535, 4 (dy mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë, e katër të qindat) lekë në muaj;

c) Shpërblimi sipas shkronjës “c” të pikës 7, nga 2061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë në muaj bëhet 2110, 4 (dy mijë e njëqind e dhjetë, e katër të qindat) lekë në muaj;

ç) Shpërblimi sipas shkronjës “e” të pikës 7, nga 618 (gjashtëqind e tetëmbëdhjetë lekë në muaj bëhet 632,8 (gjashtëqind e tridhjetë e dy, e tetë të qindat) lekë në muaj;

d) Shpërblimi sipas pikës 8/1 (për kohën e vuajtjes në burg mbi 6 muaj) nga 1030 (një mijë e tridhjetë) lekë në muaj bëhet 1054, 7 (një mijë e pesëdhjetë e katër, e shtatë të qindat) lekë në muaj;

dh) Shpërblimi sipas pikës 8/2 (për kohën e vuajtjes në burg nga 1 deri në 6 muaj) nga 618 (gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj bëhet 632,8 (gjashtëqind e tridhjetë e dy, e tetë të qindat) lekë në muaj;

e) Shpërblimi sipas shkronjës “a” të pikës 9, nga 3092 (tre mijë e nëntëdhjetë e dy) lekë në muaj bëhet 3166,2 (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë, e dy të qindat) lekë në muaj;

ë) Shpërblimi sipas shkronjës “b” të pikës 9, nga 2061 (dy mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë në muaj bëhet 2110,4 (dy mijë e njëqind e dhjetë, e katër të qindat) lekë në muaj;

f) Shpërblimi sipas sipas pikës 11, nga 1030 (një mijë e tridhjetë) lekë në muaj bëhet 1054,7 (një mijë e pesëdhjetë e katër, e shtatë të qindat) lekë në muaj;

g) Shpërblimi sipas pikës 13, nga 41 253 (dyzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj bëhet 42 243 (dyzet e dy mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë në muaj;

2. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 14 500 000 (katërmëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.480, datë 16.7.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË BAJRAM CURRIT TË MJEDISEVE TË ISH-SHTABIT TË BRIGADËS SË KËMBËSORISË NR.2230 NË BAJRAM CURRI TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli të Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-shtabit të brigadës së këmbësorisë nr.2230 në qytetin e Bajram Currit, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Bajram Currit, për t’u përshtatur për çerdhe dhe konvikt për nevojat e komunitetit.

2. Prona me numër rendor 497, “Ish-shtabi i brigadës së këmbësorisë nr.2230” në qytetin e Bajram Currit, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shetëtrërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Bajram Currit i ndalohe të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë apo t’ia japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryerregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Bajram Currit të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.481, datë 16.7.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË PUKËS TË MJEDISEVE TË ISH-HOTELIT TË USHTARAKËVE DHE TË ISH-DEGËS SË MOBILIZIMIT NË PUKË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli të Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-hotelit të ushtarakëve dhe të ish-degës së mobilizimit në qytetin Pukë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së

Pukës, për t'u përdorur për interesa publike në shërbim të komunitetit të këtij qyteti.

2. Pronat me numrat rendorë 532, "Ish-hoteli i ushtarakëve" dhe nr.535 "Ish-dega e mobilizimit" në qytetin e Pukës, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Pukës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t'i tjetërsojë ose t'ua japë përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngakohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Pukës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.482, datë 16.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË, PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Moldavisë, për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MOLDAVISË PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës të Moldavisë, këtu më poshtë të referuara si Palë Kontraktuese,

duke dëshiruar të inkurajojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik për përfitimin reciprok ndërmjet të dy vendeve për një periudhë afatgjatë,

duke pasur si objektiva të tyre krijimin e kushteve të favorshme për investimet e bëra nga investitorët e secilës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese,

ranë dakord si vijon:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi "Investim" kupton çdo lloj pasurie dhe në veçanti, jo ekskluzivisht, përfshin:

a) pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo të drejtë tjetër siç janë hipotekat, qiratë ose pengjet;

b) pjesëmarrjen me aksione, detyrimet e një shoqërie dhe çdo formë tjetër e pjesëmarrjes në shoqëri;

c) detyrimet në para ose të çdo forme në bazë të një kontrate që ka vlerë ekonomike, duke përfshirë kreditë e dhëna për një investim;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale, patentat, markat tregtare, proceset teknike, *know-how*, dëshira e mirë dhe të drejta të tjera të ngjashme, sipas ligjeve të Palës Kontraktuese;

e) koncesionet e biznesit, bazuar në ligjin e publikuar të secilës Palë Kontraktuese, përfshirë koncesionet për studimin, kërkimin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore, si dhe të drejta të tjera të dhëna me ligj;

f) mallrat që sipas një marrëveshjeje qiraje janë vënë në dispozicion të një qiramarrësi në territorin e një Pale Kontraktuese, konform ligjeve dhe rregullave të saj.

Çdo ndryshim i mundshëm në formën në të cilën janë bërë investimet apo riinvestimet nuk do të prekë karakterin e tyre si investime.

2. Termi "Të ardhura" kupton shumën që rrjedh nga një investim dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, përfshin fitimet, interesin, rritjen e kapitalit, dividendët, shpërblimet dhe pagesat, pavarësisht nga forma në të cilën e ardhura është paguar.

3. Termi "Investitor" kupton:

a) Lidhur me Republikën e Shqipërisë:

i) Personat fizikë që kanë statusin e shtetasve të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ii) Personat juridikë ose çdo njësi tjetër ligjore të inkorporuar, të krijuar apo me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjin e aplikuar në Republikën e Shqipërisë, siç janë sipërmarrësit individualë, që kanë vendqendrimin e tyre dhe realisht kryejnë aktivitetin e biznesit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Lidhur me Republikën e Moldavisë:

i) Personat fizikë që kanë statusin e shtetasve të Republikës së Moldavisë në përputhje me ligjin në fuqi në Republikën e Moldavisë.

ii) Personat juridikë ose çdo njësi tjetër ligjore të inkorporuar, të krijuar apo me fjalë të tjera të organizuar në përputhje me ligjin e aplikuar në Republikën e Moldavisë, siç janë sipërmarrësit individualë, që kanë vendqendrimin e tyre dhe realisht kryejnë aktivitetin e biznesit në territorin e Republikës së Moldavisë.

4. Termi "Territor" kupton:

a) lidhur me Republikën e Shqipërisë: territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe zonën detare e shelfin kontinental, mbi të cilat Republika e Shqipërisë, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj kombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare, ushtron të drejtat e saj sovrane e ligjore;

b) lidhur me Republikën e Moldavisë: sipërfaqen gjeografike të krijuar nga toka dhe nëntoka, ujërat dhe kolonën ajrore mbi tokë dhe ujërat territoriale, mbi të cilat Republika e Moldavisë ushtron të drejtat e sovranitetit dhe të juridiksionit, në përputhje me legjislacionin e saj dhe me ligjin ndërkombëtar.

Neni 2

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

1. Secila Palë Kontraktuese nxit në territorin e saj investimet e bëra nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese dhe i pranon këto investime në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e saj.

2. Investimeve të bëra nga investitorët e njëres Palë Kontraktuese, në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, në çdo kohë do t'u jepet një trajtim i drejtë dhe i barabartë dhe do të gëzojnë mbrojtje dhe siguri të plotë. Secila Palë Kontraktuese do të garantojë që menaxhimi, mirëmbajtja, përdorimi, gëzimi apo disponimi i investimeve të Palës tjetër Kontraktuese, në territorin e saj në asnjë rast nuk do të dëmtohen nga masa të padrejta apo diskriminuese.

3. Të ardhurat prej investimeve dhe në rastet e riinvestimit, të ardhurat që rrjedhin prej tyre gëzojnë të njëjtën mbrojtje si edhe investimet fillestare.

4. Secila Palë Kontraktuese do të vëzhgojë çdo obligim tjetër lidhur me investimet e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 3

Trajtimi i investimeve

1. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë në territorin e saj investimeve të bëra nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që ajo u ka dhënë investitorëve të vet apo investitorëve të një shteti të tretë, cildo është më i favorshëm.

2. Secila Palë Kontraktuese do t'u japë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese, lidhur me aktivitetin e tyre në marrëdhënie me investimet në territorin e saj, trajtim jo më pak të favorshëm sesa ato që ajo u ka dhënë investitorëve të vet apo investitorëve të një shteti të tretë, cildo është më i favorshëm.

3. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të konsiderohen si obligim i një Pale Kontraktuese që të shtrijë tek investitorët e Palës tjetër Kontraktuese përfitimet e çdo trajtimi, preference apo privilegji që rezulton prej:

a) anëtarësimit sipas një marrëveshjeje ekzistuese apo që do të krijohet në të ardhmen në një bashkim doganor, bashkim ekonomik, integrim ekonomik rajonal ose një marrëveshje ndërkombëtare të ngjashme;

b) çdo marrëveshje ndërkombëtare apo rregull që ka të bëjë tërësisht apo kryesisht me taksimin.

Neni 4

Shpronësimi

1. Investimet e investitorëve të secilës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, nuk do të shpronësohen ose nuk do të jenë subjekt i ndonjë mase tjetër që mund të ketë efekt të njëjtë me atë të shpronësimit (këtu më poshtë referuar si "shpronësim"), me përjashtim kur kërkohet për interes të sigurimit kombëtar, mbi baza jodiskriminuese dhe kundrejt një pagese të menjëhershme, të përshtatshme dhe kompensimi efektiv. Ky kompensim do të llogaritet me vlerën e tregut të investimit në momentin përpara se të merret masa apo ky shpronësim të bëhet publikisht i njohur, cildo është më i hershmi, ku do të përfshijë interesin e zakonshëm tregtar prej datës së shpronësimit deri në datën e pagesës dhe do të jetë lirisht i transferueshëm dhe lirisht i konvertueshëm.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të jenë të zbatueshme, gjithashtu ku një Palë Kontraktuese shpronëson pasuritë e një shoqërie e cila është krijuar sipas ligjeve në fuqi në secilën pjesë të territorit të saj dhe në të cilën investitorët e Palës tjetër Kontraktuese zotërojnë aksione.

Neni 5

Kompensimi për humbjet

1. Investitorët e një Pale Kontraktuese, investimet e të cilëve pësojnë humbje në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për shkak të konfliktit të armatosur, revolucionit, gjendjes së emergjencës kombëtare, kryengritjeve, luftës civile apo ngjarjeve të ngjashme do t'u jepet nga Pala e fundit Kontraktuese në lidhje me kthimin, zhdëmtimin, kompensimin apo një zgjidhje tjetër të vlefshme, një trajtim jo më pak të favorshëm sesa kjo Palë Kontraktuese u jep investitorëve të vet ose të një shteti të tretë cilido qoftë me i favorshmi për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 6

Riatdhesimi i kompensimeve dhe i të ardhurave

1. Secila Palë Kontraktuese, lidhur me investimet e investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese, pas përmbushjes së detyrimeve fiskale të saj, nuk do të frenojë transferimin e investimeve dhe të ardhurave të saj. Transferimi do të jetë efektiv, pa vonesa, në një monedhë lirisht të konvertueshme në tregun e lirë të këmbimit në datën e transferimit.

2. Këto transferime do të përfshijnë në veçanti, por jo ekskluzivisht:

- a) kapitalin dhe çdo shtesë në kapital për mirëmbajtjen apo rritjen e investimit;
- b) fitimet, interesin, aksionet dhe të ardhura të tjera në vazhdimësi;
- c) fondet për shlyerjen e huave lidhur me një investim;
- d) shpërblimet dhe pagesat;
- e) të ardhurat nga shitja apo likuidimi i investimit të plotë apo një pjesë të tij;
- f) kompensimin sipas neneve 4 dhe 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Zëvendësimi me të drejta të plota (Subrogimi)

1. Në se investimet e bëra nga një investitor i njëjës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese janë siguruar kundrejt një risku jotregtar sipas një sistemi ligjor të garantuar, Pala e fundit Kontraktuese do të njohë çdo zëvendësim me të drejta të plota të siguruar brenda të drejtave të investitorit të lartpërmendur në përputhje me termat e garancisë, që do të bëhen të njohura nga Pala tjetër Kontraktuese, pa paragjykuar të drejtat e investitorit sipas nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje.

2. I siguruari nuk do të ketë të drejtë që të ushtrojë çdo të drejtë tjetër që mund të ketë pasur investitori për të ushtruar.

3. Mosmarrëveshjet ndërmjet një Pale tjetër Kontraktuese dhe të siguarit do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet Palëve Kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese, lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, përsa është e mundur, do të zgjidhet me bisedime nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Në qoftë se mosmarrëveshja nuk është e mundur të zgjidhet brenda gjashtë muajve prej fillimit të bisedimeve, ajo do t'i nënshtrohet me kërkesën e njëjës prej Palëve Kontraktuese një gjykate arbitrazhi.

3. Gjykata e arbitrazhit do të krijohet *ad-hoc*, si më poshtë: çdo Palë Kontraktuese do të emërojë një gjykatës dhe këta dy gjykatës do të bien dakord të zgjedhin një shtetas të një shteti të tretë si kryetar. Gjykatësit do të zgjidhen brenda tre muajve dhe kryetari brenda pesë muajve, nga data ku secila Palë Kontraktuese i njofton Palës tjetër Kontraktuese dëshirën e saj që t'ia nënshtrojë mosmarrëveshjen një gjykate arbitrazhi.

4. Në rast se brenda afateve të specifikuara në paragrafin 3 të këtij neni nuk janë bërë emërimet e nevojshme, secila Palë Kontraktuese mund, që në mungesë të ndonjë marrëveshjeje tjetër të ftojë Presidentin e Gjykatës Ndërkombëtare të drejtësisë të bëjë emërimet e nevojshme. Në rast se Presidenti i Gjykatës është shtetas i ndonjëres prej Palëve Kontraktuese ose i ndalohet që të kryejë funksionet e mësipërme, zëvendëspresidenti ose nëse ai, gjithashtu është shtetas i njëres prej Palëve Kontraktuese ose nëse ai ndalohet që të kryejë funksionet e mësipërme, anëtari më i vjetër i Gjykatës i cili nuk është shtetas i ndonjëres prej Palëve Kontraktuese do të ftohet që të bëjë emërimet e nevojshme.

5. Gjykata e arbitrazhit do të vendosë në bazë të respektimit të ligjit, duke përfshirë në veçanti këtë Marrëveshje dhe marrëveshje të tjera pasuese ndërmjet Palëve Kontraktuese, si dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare.

6. Gjykata i përcakton vetë procedurat, përveçse kur Palët kontraktuese vendosin ndryshe.

7. Gjykata do t'i marrë vendimet me shumicë votash. Ky vendim do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja Palët Kontraktuese.

8. Çdo Palë Kontraktuese do të përballojë vetë shpenzimet për gjykatësin e zgjedhur prej saj dhe për atë të përfaqësimit. Shpenzimet për kryetarin, si dhe shpenzime të tjera do të përballohen në pjesë të barabarta nga të dyja Palët Kontraktuese. Megjithatë, gjykata mund që me vendim të prerë të ngarkojë njëren Palë Kontraktuese që të përballojë një pjesë më të madhe të shpenzimeve dhe ky vendim do të jetë i detyrueshëm për të dyja Palët Kontraktuese.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet investitori dhe një Pale Kontraktuese

1. Mosmarrëveshjet ndërmjet një investitori të një Pale Kontraktuese dhe Palës tjetër Kontraktuese, në lidhje me një obligim të kësaj të fundit sipas kësaj Marrëveshjeje, për sa i përket një investimi të mëparshëm, përsa të jetë e mundur, do të zgjidhen në mënyrë miqësore.

2. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk mund të zgjidhen miqësisht brenda gjashtë muajve nga data që secila Palë Kontraktuese kërkon zgjidhje, investitori mund të zgjedhë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjykatën kompetente të Palës Kontraktuese në të cilën investimi ka qënë kryer ose arbitrazhi Ndërkombëtar.

3. Kur mosmarrëveshja i ka kaluar për zgjidhje arbitrazhit ndërkombëtar, investitori mund t'ia kalojë për zgjidhje mosmarrëveshjen gjithashtu:

a) Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve të krijuara nga Konveta për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera, e hapur në nënshkrimin në Washington D.C. në 18 mars 1965, për arbitrimin ose pajtimin, apo:

b) një gjykatë të përkohshme të krijuar sipas rregullave të arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Ligjin Tregtar Ndërkombëtar (U.N.C.I.T.R.A.L.).

4. Gjykata e arbitrazhit do të zgjidhë mosmarrëveshjet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe rregullave dhe parimeve të së drejtës ndërkombëtare. Vendimet e arbitrazhit do të jenë përfundimtare dhe detyruese për të dyja palët në mosmarrëveshje. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër që të zbatojë pa vonesë vendimet në përputhje me legjislacionin e vendit të saj.

5. Gjatë proceseve të arbitrimit apo zbatimit të vendimit, Pala Kontraktuese në mosmarrëveshje nuk do të shfrytëzojë për kompesim objektin që investitori i Palës tjetër Kontraktuese ka marrë sipas një kontrate sigurimi në përputhje me të gjitha apo një pjesë të dëmit apo të humbjes.

Neni 10
Zbatimi i rregullave të tjera

Nëse dispozitat ligjore të secilës Palë Kontraktuese apo obligimet sipas ligjit ndërkombëtar ekzistues aktual apo krijuar këtu më poshtë ndërmjet Palëve Kontraktuese, përveç kësaj Marrëveshjeje përmbajnë një rregull, të përgjithshëm apo specifik, që i jep të drejtën investimeve të investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese e trajtimit më të favorshëm se sa ai që siguron kjo Marrëveshje, një rregull i tillë për t'u shtrirë aty ku është më i favorshëm do të mbizotërojë mbi këtë Marrëveshje.

Neni 11
Konsultimet

Përfaqësuesit e Palës Kontraktuese do të mbajnë, kurdoherë që të jetë e nevojshme, konsultimet për çdo problem që do të dalë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Këto konsultime do të mbahen me propozimin e njëres Palë Kontraktuese në vendimin dhe kohën që do të bien dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike

Neni 12
Zbatimi

Kjo Marrëveshje do të zbatohet edhe për investimet e bëra më parë nga investitorët e secilës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Neni 13
Hyrja në fuqi, kohëzgjatja, përfundimi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas ditës së tridhjetë pas datës në të cilën Palët Kontraktuese kanë njoftuar njëra-tjetrën lidhur me përmbushjen e kërkesave të procedurave të brendshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për një periudhë dhjetëvjeçare. Megjithatë kjo Marrëveshje do të rinovohet në mënyrë të heshtur për një periudhë dhjetëvjeçare nëse nga asnjë Palë Kontraktuese nuk është dhënë njoftimi për përfundimin e vlefshmërisë së Marrëveshjes së paku një vit përpara datës së përfundimit të vlefshmërisë së saj. Secila palë rezervon të drejtën për të përfunduar Marrëveshjen nëse njofton të paktën një vit përpara datës së përfundimit të vlefshmërisë së periudhës së rinovimit.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshojë nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim ndërmjet Palëve Kontraktuese. Çdo ndryshim do të hyjë në fuqi sipas të njëjtës procedurë që kërkohet për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes ekzistuese.

Për investimet e bëra përpara datës së përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, nenet e mësipërme do të vazhdojnë të jenë në fuqi për një periudhë të mëtejshme dhjetëvjeçare prej kësaj date.

Bërë në Chisinau më 11 qershor në dy origjinale në gjuhët shqip, moldave dhe anglisht, duke qenë të gjitha tekstet me fuqi të barabartë.

Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr.483, datë 16.7.2004

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MALIT TË ZI, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUR, TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM DHE AKTIVITETEVE TË TJERA ILEGALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e trakteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Malit të Zi, për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera ilegale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MALIT TË ZI MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM, SI DHE AKTIVITETEVE TË TJERA ILEGALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Malit të Zi, këtu të quajtura "Palë Kontraktuese",

me qëllim zhvillimin e kontratave dypalëshe midis tyre,
thellësisht të interesuara që të bashkëpunojnë në luftën kundër krimit dhe në veçanti kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkufitar,

duke dëshiruar të shtojnë më tej përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar,

duke qenë të bindura për nevojën për të harmonizuar aksionet kundër krimit të organizuar, krimit ndërkufitar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme me ndikim ndërkombëtar,

duke pasur parasysh legjislacionet kombëtare, si dhe klauzolat e instrumenteve juridike ndërkombëtare, të cilat shtetet e tyre janë palë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

I. Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

1. Luftën kundër terrorizmit;
2. Luftën kundër krimit të organizuar, zbulimit dhe hetimit të personave dhe organizatave të përfshira në:

a) Trafikimin, prodhimin dhe përdorimin e paligjshëm të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope;

- b) Trafikimin e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit të fëmijëve;
 - c) Trafikimin e paligjshëm të mallrave, teknologjive dhe materialeve bërthamore, teknologjive dhe produkteve strategjike, armëve të zjarrit, municionit dhe eksplozivëve dhe substancave toksike, si dhe komponentët e tyre;
 - d) Krimet në fushën e shfrytëzimit seksual të personave;
 - e) Kontrabandën e gurëve, metaleve të çmuar, objekteve historike dhe/ose kulturore, të cilat i përkasin pronës kombëtare ose janë pronë ndërkombëtare kulturore;
 - f) Falsifikimin e dokumenteve, monedhave dhe mjeteve të tjera të pagesës, si dhe letrave me vlerë;
 - g) Lojërat e fatit të paligjshme dhe aktet e mashtrimit të përdorura në lojërat e ligjshme;
 - h) Parandalimin, identifikimin dhe hetimin e vjedhjeve dhe të trafikimit të automjeteve të vjedhura dhe të rasteve të shkeljeve të qarkullimit rrugor.
3. Lufta kundër aktiviteteve ekonomike ndërkombëtare të paligjshme, kontrabandës, evazionit fiskal dhe operacioneve për riqarkullimin e parave ose të përfitimeve nga aktivitete ilegale.
4. Luftën kundër migracionit të paligjshëm:
- a) Luftën kundër migracionit të paligjshëm dhe rrjeteve të implikuara në trafikimin e personave;
 - b) Identifikimin e transportuesve dhe agjencive/shoqërive të udhëtimit ose turistike të implikuara në aktivitete që lidhen me trafikun e personave.
 - c) Zbulimin e dokumenteve të udhëtimit dhe vizave false ose të falsifikuara.
- II. Palët Kontraktuese do të zhvillojnë asistencë reciproke në këto fusha:
- a) Në drejtim të trajnimeve të përbashkëta për çështje të luftës kundër krimit të organizuar dha atij ndërkufitar;
 - b) Për organizimin dhe administrimin e sistemit të evidentimit të dokumenteve të identifikimit;
 - c) Për zhvillimin e metodave dhe sistemeve të seleksionimit, përgatitjes dhe formimit profesional respektiv, promovimi i specialistëve të të dyja Palëve Kontraktuese për çështjet e përmendura në paragrafin I të këtij neni.

Neni 2

Mënyra e bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis Palëve Kontraktuese do të realizohet nëpërmjet:

- a) shkëmbimit të informacionit në fushat e përshkruara në nenin 1, në lidhje me personat dhe grupet të implikuara ose që dyshohet që janë të implikuara në aktivitetet kriminale të specifikuar, aksionet e tyre, metodat e përdorura dhe objektivat e ndjekura me paramendim nga ana e tyre, si edhe çdo element tjetër me interes operativ të nevojshëm për parandalim në luftën ndaj këtyre krimeve;
- b) marrjes së masave ose kryerjes së aksioneve të përbashkëta, për të cilat bashkërisht bihet dakord nga të dy autoritetet kompetente të të dy shteteve;
- c) shkëmbimit të specialistëve në fushat e interesit të përbashkët;
- d) shkëmbimit të dokumentacionit, botimeve dhe studimeve shkencore në fusha me interes të përbashkët;
- e) shkëmbimeve të eksperiencave që kanë të bëjnë me mjetet dhe metodat e përdorura për parandalimin, zbulimin, si dhe hetimin e aktiviteteve dhe akteve të terrorizmit, të krimit të organizuar ndërkombëtar, krimit ndërkufitar dhe të krimeve të tjera.

Neni 3

Autoritetet kompetente

1. Palët Kontraktuese përcaktojnë si autoritete kompetente, për të zbatuar klauzolat e kësaj Marrëveshjeje, për Palën Kontraktuese Shqiptare, Ministrinë e Rendit Publik, ndërsa për Palën Kontraktuese të Malit të Zi, Ministrinë e Brendshme.

2. Për të siguruar lidhjen operacionale, secili autoritet kompetent do të caktojë një person pikë kontakti, të dhënat e të cilit si emri, mbiemri, funksioni, numrat e telefonit dhe faksit do të komunikohen midis Palëve Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

3. Me qëllim që të vihet në praktikë bashkëpunimi i parashikuar në nenin 1 dhe nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese, brenda juridiksionit të tyre ligjor, mund të nënshkruajnë protokolle bashkëpunimi, në përputhje me legjislacionet kombëtare.

Neni 4

Shkëmbimi i informacionit

Palët Kontraktuese do të japin në mënyrë reciproke asistencë në përpunimin dhe analizimin e informacioneve, në fushat e parashikuara në nenin 1 dhe mund të furnizojnë autoritete kompetente të Palës tjetër Kontraktuese, me mjetet dhe teknologji specifike, duke respektuar detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra në këtë fushë.

Neni 5

Mbrojtja e të dhënave

Me qëllim që të sigurohet mbrojtja e të dhënave që u referohen personave (të dhënat personale), të cilat shkëmbehen nga Palët Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar të shteteve të Palëve Kontraktuese, do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

1. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhëna të tilla, mund t'i përdorë ato vetëm për qëllim dhe në bazë të kushteve të vendosura nga Pala Kontraktuese dërguese.

2. Pala Kontraktuese, e cila merr të dhënat, me anë të kërkesës së Palës Kontraktuese dërguese, do të informojë këtë të fundit mbi mënyrën në të cilën janë përdorur të dhënat dhe mbi rezultatet e përdorimit të tyre.

3. Të dhënat e transmetuara do të bëhen të vlefshme për autoritetet kompetente për të luftuar krimin në të gjitha format e tij. Të dhëna të tilla do të vendosen në dispozicion të një autoriteti tjetër vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës dërguese përkatëse.

4. Pala Kontraktuese, e cila dërgon të dhënat e kërkuara, do të sigurojë vlefshmërinë e të dhënave dhe të sigurohet që është absolutisht e domosdoshme t'i bëjë të vlefshme këto të dhëna dhe përmbajtjen e tyre, në përputhje me qëllimin për të cilën ato janë vënë në dispozicion. Nëse ajo konstaton ose njoftohet se është furnizuar me të dhëna të pasakta ose të dhëna të tjera të cilat nuk duhet të ishin transmetuar, Pala Kontraktuese e cila i merr ato, menjëherë do të bëjë ndryshimet e duhura mbi të dhënat e gabuara dhe respektivisht, do të shkatërrojë menjëherë çdo të dhënë të gabuar ose që është dhënë në mënyrë të palejueshme.

5. Me anë të kërkesës së një personi që është objekt i të dhënave personale, këto të dhëna dhe mënyra në të cilën këto të dhëna janë përdorur ose do të përdoren, do t'i bëhen të njohura ose t'i paraqiten personit përkatës. Këto të dhëna do të bëhen të vlefshme për ankuesin deri në atë masë që e lejon legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese, e cila i ka transmetuar këto të dhëna.

6. Pala Kontraktuese, e cila dërgon të dhëna, do të specifikojë afatin ligjor për eliminimin e tyre, në bazë të legjislacionit kombëtar. Brenda kësaj periudhe, ndonjë e dhënë e cila ka lidhje me personin në fjalë do të eliminohet në rastet kur përdorimi i tyre nuk është më i nevojshëm. Pala Kontraktuese dërguese e të dhënave do të njoftohet mbi eliminimin e tyre, si edhe për motivin e eliminimit të tyre. Të gjitha të dhënat e marra do të asgjësohen me shfuqizimin e Marrëveshjes në fjalë.

7. Palët Kontraktuese mbajnë evidencë mbi dhënien, marrjen dhe eliminimin e të dhënave personale.

8. Palët Kontraktuese do të sigurojnë një mbrojtje më efikase të të dhënave, me qëllim që të mos lejojë akses për personat e pautorizuar për këto të dhëna dhe nuk do të lejojnë të modifikohen ose të bëhen publike këto të dhëna.

Neni 6 **Konfidencialiteti**

1. Palët Kontraktuese garantojnë konfidencialitetin e këtyre të dhënave, informacioneve, materialet dhe mjetet e shkëmbyera reciprokisht në bazë të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë edhe kërkesat e marra për këtë qëllim, nëse këto kualifikohen si të tilla në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktuese dërguese. Niveli i sigurisë, i përcaktuar nga Pala Kontraktuese që i dërgon, nuk mund të modifikohet.

2. Transmetimi i materialeve, informacioneve dhe mjeteve teknike të furnizuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje për një palë të tretë, bëhet e mundshme vetëm me anë të një miratimi me shkrim paraprak të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese dërguese.

Neni 7 **Refuzimet**

1. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të refuzojë, pjesërisht ose plotësisht, ose mund të vendosë kushte për zgjidhjen e një kërkesë të bashkëpunimit ose të shpërndarjes së informacionit, nëse e konsideron që një kërkesë e tillë mbi dhënien e këtij informacioni mund të japë efekt në sovranitetin, sigurinë kombëtare të Palës Kontraktuese të kërkuar, ose kur dhunon legjislacionin e saj të brendshëm, ose detyrime të tjera të përmbajtura në marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Në një rast të tillë, motivi i refuzimit apo kushtëzimi do të njoftohet me shkrim te Pala tjetër Kontraktuese sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 8 **Komisioni i përbashkët**

1. Palët Kontraktuese do të ngrenë një komision të përbashkët për promovimin, vlerësimin, shtimin dhe zhvillimin më tej të bashkëpunimit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, ku do të jenë prezent 5 anëtarë nga secila Palë. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike në lidhje me përbërjen e komisionit të përbashkët.

2. Komisioni i përbashkët do të mbledhet të paktën një herë në vit, në mënyrë alternative në Mal të Zi dhe në Shqipëri. Secila prej Palëve Kontraktuese mund të propozojë, nëse është e nevojshme, organizimin e takimeve të tjera shtesë të komisionit të përbashkët.

Neni 9 **Shpenzimet**

Shpenzimet për implementimin e klauzolave të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen nga Palët Kontraktuese mbi baza të reciprocitetit. Për shkëmbimin e delegacioneve, shpenzimet e transportit ndërkombëtar vajtje-ardhje do të mbulohen nga Pala Kontraktuese dërguese, ndërsa akomodimi, transporti i brendshëm dhe asistenca mjekësore në raste emergjente do të mbulohet nga Pala Kontraktuese e cila pret delegacionin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 10 **Raportet me të tretët**

Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të paragjykojnë të drejtat dhe detyrimet e ndërmarra nga shtetet e të dyja Palëve Kontraktuese, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe.

Neni 11
Dispozita të fundit

1. Marrëveshja nënshkruhet për një periudhë kohe të papërcaktuar.
 2. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit të bërë nëpërmjet kanaleve diplomatike, me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë reciprokisht njëra-tjetrën mbi përmbushjen e procedurave të brendshme të nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi.
 3. Marrëveshja mund të modifikohet në çdo kohë me pëlqimin e Palëve Kontraktuese. Modifikimi do të hyjë në fuqi sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni.
 4. Secila prej Palëve Kontraktuese mund denoncojë Marrëveshjen nëpërmjet rrugëve diplomatike. Marrëveshja përfundon vlefshmërinë pas gjashtë muajsh nga data në të cilën Pala tjetër Kontraktuese ka marrë njoftimin e denoncimit.
 5. Çdo mosmarrëveshje ose divergjencë përsa i përket interpretimit ose aplikimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet konsultimeve ndërmjet Palëve Kontraktuese, në kuadër të komisionit të përbashkët, ndërsa në rastin kur kjo gjë nuk është e mundur, zgjidhja do të bëhet nëpërmjet rrugëve diplomatike.
- Firmosur në Podgoricë, më 31.10.2003 në tri kopje origjinale, në gjuhët, shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekset autentikisht të barabarta. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në përkthim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr.485, datë 16.7.2004

PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE BUXHETORE BASHKISË SË ELBASANIT, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË QENDRËS SOCIALE “BALASHE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 20.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” dhe të nenit 13 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë së Elbasanit, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i transferohet fondi prej 648 350 (gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekësh, për mbulimin, për 6-mujorin e dytë të këtij viti, e shpenzimeve administrative të qendrës sociale “Balashe”, Elbasan.
 2. Ky fond t’i pakësohet buxhetit të Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, miratuar për vitin 2004.
 3. Ngarkohen Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe kryetari i bashkisë së Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.487, datë 16.7.2004

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA
MJEDISEVE TË BAZËS NDIHMUESE NË SARANDË DHE BAZËS NDIHMUESE NË
SHËNGJIN NGA MINISTRIA E MBROJTJES, MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË
USHQIMIT, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “c” të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediseve të oficinës mekanike, me sipërfaqe 360 m², të bankinës së shkallës KS, me sipërfaqe 62 m², dhe trullit funksional të tyre, me sipërfaqe 2498 m², komponente të bazës ndihmuese në Sarandë, si dhe mjediseve të bankinës KS, me sipërfaqe 323 m², e truallit funksional të saj, me sipërfaqe 1699 m², komponente të bazës ndihmuese në Shëngjin, sipas genplaneve që i bashkëlidhen këtij vendimi, t'u ndryshojë përgjegjësia e administrimit dhe të kalojë nga Ministria e Mbrojtjes e Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, për t'u përdorur për zbatimin e projektit pilot të zhvillimit të peshkimit, financuar nga Banka Botërore.

2. Nga pronat me numrat rendorë 696 “Baza ndihmuese” në Sarandë dhe 974 “Baza ndihmuese” në Shëngjin, që janë në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të hiqen pronat dhe sipërfaqet e truallit të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Rr. Qemal Stafa, kati i parë, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE 1500

Doli nga shtypi më 30.7.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë